




Vjedhja e të dhënave:
Çfarë është dhe si
mund ta shmangni atë





Vjedhja e të dhënave është ekfiltrimi, blerja dhe ruajtja e paligjshme e të dhënave të ndjeshme të një personi ose organizate.

Këto të dhëna zakonisht përfshijnë informacione personale të individëve si: emrat, adresat, fjalëkalimet, numrat e sigurimeve shoqërore ose detaje financiare.



Sulmuesit përdorin teknika të përpunuara dhe mjete të ndryshme për të vjedhur të dhëna në internet ose për të mashtruar njerëzit për t'i zbuluar ato. Disa nga faktorët që ndikojnë në vjedhjen e të dhënave tuaja janë:

Fjalëkalime të dobëta.

Mashtrimet online

Programe të pa përditësuara


Shkarkime të infektuara me malware nga interneti

Abuzimi i informacionit tuaj






Si të siguroni të dhënat tuaja



Përdorni një fjalëkalim të fortë.

Krijoni një fjalëkalim të fortë që të përmbajë të paktën tetë karaktere në një kombinim të shkronjave të mëdha dhe të vogla, numrave dhe simboleve.



Përdorni vërtetimin me shumë faktorë

Ky lloj vërtetimi kërkon më shumë sesa thjesht një fjalëkalim për të hyrë në llogarinë tuaj.



Kini kujdes kur përdorni rrjetet publike.

Një Wi-Fi publik shpesh nuk i aplikon masat e duhura të sigurisë dhe si rezultat, hakerët e favorizojnë atë si një pikë hyrjeje në pajisjet e përdoruesve.



KUJDES ÇFARË SHPËRNDANI NË RRJETET SOCIALE

Çdo informacion rreth jush që përfundon në internet mund të përdoret për të kryer mashtrime

MBYLLNI LLOGARITË QË NUK I PËRDORNI

Çdo llogari që krijoni në internet kërkon disa informacione personale. Për të qëndruar sa më privatë në internet, sigurohuni që të fshini të gjitha llogaritë që nuk i përdorni për të zvogëluar gjurmët tuaja digjitale.